

## AKT THEMELIMI

### Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "I-A GRAZIA GROUP" SH. P. K.

Sot, më datën 11/10/2019, **Zj. Grazia ILGRANDE** e lindur në Itali me datë 23 Qershor 1976 mbajtëse e kartës së identitetit me numër AU 6034176, banues në Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar **Z. Stefano CAVALLO**, i lindur në Itali me datë 24.11.1969, banues në Itali, mbajtës i kartës së identitetit me numër AS 7389373 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe **Z. Giuseppe DEPALO**, i lindur në Itali me datë 08.05.1973, banues në Itali, mbajtës i kartës së identitetit me numër AS 1500242 madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "I-A GRAZIA GROUP" Sh. P. K. si më poshtë vijon

#### Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin "I-A GRAZIA GROUP"

Ortakë të kësaj shoqërie janë **Zj. Grazia ILGRANDE**, **Z. Stefano CAVALLO** dhe **Z. Giuseppe DEPALO**.

Administratore e kësaj shoqërie caktohet **Zj. Grazia ILGRANDE** për një periudhë deri në 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

#### Neni 2

Shoqëria "I-A GRAZIA GROUP" gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Sh. P. K.". Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë "I-A GRAZIA GROUP" SH.P.K, është : **Lagja 04, Rruga "Fetah Billaca" Pallati nr. 1133, zona Kadastrale 8514, Kati i tretë, përballë shkollës "Jusuf Puka" Durrës**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

#### Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

#### Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Import, eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë i artikujve industrial, elektroshtëpiake, elektrike, ushqimore, higjienosanitare, stofra, tekstile të tjera

dhe lëndë e parë dhe ndihmëse, makineri dhe pajisje të tjera prodhimi për tekstile dhe veshje, materiale ndertimi etj.

- Transport mallrash dhe pasagjerësh brenda dhe jashtë vendit
- Tregti e materialeve të ndërtimit, të lëndëve të para, inerte, brenda e jashtë vendit
- Tregti e automjeteve të ndryshme, autovetura apo automjete, transport pasagjerësh brenda dhe jashtë vendit.
- Sherbime sigurie
- Sherbime pastrimi
- Tregti e automjeteve motorike, elektrike dhe e mjeteve të tjera
- Sherbim imobiliar. Konsulence, agjensi turistike, sherbime ndermjetesimi etj.
- Hapje të linjave të rrobaqepësisë fason, shërbime të ndryshme, prodhim të konfeksioneve dhe veshjeve, tekstile të pambukta dhe të leshta të të gjitha llojeve, duke punuar për vete dhe për porosi të të tretëve brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Larje dhe ngjyrosje të tekstileve dhe të konfeksioneve.
- Prodhim të veshjeve të gatshme artizanale të të gjitha llojeve, import, eksport i tyre

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuota në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuota të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

**Zj. Grazia ILGRANDE** zotëruese e një kuota me vlerë të përgjithshme 40.000 leke që përbën 40% të kapitalit të shoqërisë.

**Z. Stefano CAVALLO** zotëruese e një kuota me vlerë të përgjithshme 30.000 leke që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë.

**Z. Giuseppe DEPALO** zotëruese e një kuota me vlerë të përgjithshme 30.000 leke që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ( pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta ). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themelues të shoqërisë.



#### Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### Neni 8



Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

### Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### ORTAKET E SHOQERISE

**Grazia ILGRANDE**

GRAZIA ILGRANDE



**Stefano CAVALLO**

STEFANO CAVALLO



**Giuseppe DEPALO**

GIUSEPPE DEPALO

